



Bachelor

në “Arkitekturë Peizazhi”

Program Bachelor në "Arkitekturë Peizazhi"

Programi i studimit “Arkitekturë Peizazhi” në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) ofrohet nga Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit dhe është i vetmi program i këtij lloji në të gjitha trojet shqiptare.

Programi është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje me udhëzimet dhe standardet ndërkombëtare të ECLAS (European Council of Landscape Architecture Schools) dhe IFLA Europe (International Federation of Landscape Architects – European Region). Ky program synon të formojë profesionistë të aftë për të planifikuar, projektuar, menaxhuar dhe zhvilluar peizazhin në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të mjedisit.

Objektivat e Programit

Programi i studimit “Arkitekturë Peizazhi” në Universitetin Bujqësor të Tiranës ka për qëllim:

- Formimin e profesionistëve të kualifikuar për planifikimin, projektimin, menaxhimin dhe zhvillimin e peizazheve urbane dhe rurale.
- Pajisjen e studentëve me njohuri teorike, praktike dhe teknologjike për zgjidhjen e problemeve të hapësirës publike dhe mjedisit natyror.
- Nxitjen e aftësive kreative dhe multidisiplinare për të përballuar sfidat që lidhen me urbanizimin, ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e biodiversitetit.
- Integrimin e standardeve ndërkombëtare (ECLAS, IFLA Europe) në praktikatat akademike dhe profesionale të fushës së arkitekturës së peizazhit.

Kompetencat Kryesore

Pas përfundimit të programit, studentët zotërojnë kompetenca në:

- Planifikim peizazhi: Përcaktimin e nevojave për zona të gjelbëra, analizimi i territorit dhe zgjidhja e problemeve që lidhen me fragmentimin e peizazhit dhe përdorimin më efektiv të hapësirës.
- Projektim Peizazhi: Konceptimi dhe realizimi i hapësirave publike funksionale, estetike dhe të qëndrueshme.
- Përdorimi i teknologjive dixhitale: GIS, AutoCAD, 3D modeling dhe softuerë vizualizimi për projektimin e peizazhit.

- Puna në ekipe multidisiplinare: Bashkëpunimi me arkitektë, urbanistë, inxhinierë dhe ekologë për projekte komplekse.
- Komunikim profesional: Prezantimi dhe mbrojtja e ideve përballë klientëve, institucioneve dhe publikut.

Mundësi Karriere

Diploma në Arkitekturë Peizazhi ofron akses në një treg pune në zgjerim, me mundësi punësimi në:

- Studio projektimi të arkitekturës së peizazhit dhe urbanistikës.
- Administratë publike për menaxhimin dhe zhvillimin e hapësirave publike, parqeve dhe zonave të mbrojtura.
- Organizata kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me planifikimin e territorit dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Firma të zhvillimit dhe menaxhimit të peizazhit, dizajnit të hapësirave të gjelbërta dhe turizmit të qëndrueshëm.
- Pavarësi profesionale si konsulent apo projektues i pavarur.
- Programi prej dy vitesh ofron edhe diplomë duale me Universitetin e Viterbos (Itali), duke zgjeruar më tej perspektivat ndërkombëtare të karrierës.

Qasja e mësimdhënies: Mësimi me projekte dhe format “studio”

Programi është i ndërtuar mbi një metodologji interaktive dhe praktike, ku studentët:

- Punojnë mbi projekte reale të zhvillimit të hapësirave publike dhe rehabilitimit të peizazhit.
- Marrin pjesë në studime terreni, analiza mjedisore dhe punë praktike me institucionet dhe komunitetet lokale.
- Zhvillojnë aftësi në format “studio”, duke kombinuar leksionet teorike me zgjidhje konkrete projektimi dhe prezantim para ekspertëve.
- Përdorin laboratorët e projektimit dhe softuerët më të fundit të vizualizimit 3D.

Pse duhet zgjedhur ky program?

- Standardet Evropiane: Programi është projektuar sipas udhëzimeve të ECLAS dhe IFLA Europe.
- Profesioni i së ardhmes: Arkitektura e peizazhit është ndër profesionet më të kërkuara për zhvillim të qëndrueshëm urban dhe rural.
- Përjasje praktike: Fokus në projekte konkrete dhe metodologji “studio” që përgatitin studentët për tregun e punës.
- Mundësi ndërkombëtare: Diplomë duale me Universitetin e Viterbos dhe bashkëpunime me rrjete profesionale evropiane.
- Kontribut për shoqërinë: Profesioni i arkitektit të peizazhit ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ruajtjen e mjedisit.

- parqet etj. ashtu edhe në sektorin privat, në studio të ndryshme projektimi ose si profesionistë të lirë.